



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:154317

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05382274

KPPP.nr.1746/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbaremore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit Posta e Kosovës Sh.A, me NUI: 811285205, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbaremore P.nr.151/2023 të datës 06.07.2023, të Përmbareuesit Privat Emine Sherifi Lubeniqi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 08.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Posta e Kosovës Sh.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.151/2023 të datës 06.07.2023, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI.

**A r s y e t i m**

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me datë 06.07.2023, ka lëshuar Urdhrit Përmbaremore P.nr.151/2023, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit përmbaremore, Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.08-93/2022-B të datës 14.12.2022, me të cilin është obliguar debitori që në emër të masës ndëshkimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t’ia bëjë pagesën kreditorit në shumën prej 2,000.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se dokumenti për ekzekutim-vendimi, nuk ka titull ekzekutiv në kuptim të nenit 21 lidhur me nenin 38 të LPP-së. Tutje ka shtuar se në propozimin për përmbarrim mungon adresa e vendbanimit-vendqëndrimi apo selia afariste e kreditorit dhe e debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet të cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 22 par.1.2 dhe 38 të LPP-së. Ka theksuar se mungesa e njërit prej kushteve të përcaktuara me nenin 29 par.3 të LPP-së, e bën dokumentin përkatës përmbarrimor të papërshtatshëm për përmbarrim. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarrimor i Përmbarruesit Privat, dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet e procedurës, në lartësinë të cilën e përcakton kjo gjykatë.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar thëniet në prapësimin e debitorit, ngase urdhri i Përmbarruesit Privat P.nr.151/2023 është në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, dhe janë plotësuar kushtet për përmbarrim. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin për përmbarrim të lëshuar nga Përmbarruesi Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, në paragrafin 1 nen paragrafin 2 është përcaktuar se dokumente përmbarruese janë *“vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia...”*.

Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se “*Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...*”, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se “*Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë*”.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit të Punës 01 Nr.08-93/2022-B të datës 14.12.2022, në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi 01 Nr.08-93/2022-B i datës 14.12.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi 01 Nr.08-93/2022-B i datës 14.12.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “*Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”, ngase Vendimi 01 Nr.08-93/2022-B i datës 14.12.2022, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 19.05.2023, e cila vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Andaj, meqenëse në këtë çështje përmbartimore gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1746/23, me datë 08.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.